



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 335/ 9 prot.

Datë 03.03.2026

V E N D I M
Nr. 332/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “HTM” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68215-11-10-2025, me objekt " ZBATIMI I PLANIT PILOT: BLERJA DHE INSTALIMI I PANELEVE DIELORE”. (Kontratë me Celësa në dorë), me fond limit 17.777.820 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 22.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “HTM” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “HTM” Shpk me NIPT K97006004D dhe adresë: Lagja Perash, Rruga Rrojej, Nr 44, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Portual Durrës me adresë: Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës.

Subjekte të interesuara:

OE “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NUIS M01323012A me adresa: Rruga : "At Zef Valentini", Kompleks Magazina, Kati 1, Njësia Bashkiake 11, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68215-11-10-2025, me objekt " ZBATIMI I PLANIT PILOT: BLERJA DHE INSTALIMI I PANELEVE DIELORE”. (Kontratë me Celësa në dorë), me fond limit 17.777.820 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 22.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 22.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 09.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “HTM” Shpk	13,333,365 I skualifikuar
2. “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk	16,400,000 I kualifikuar
3. “Solar Energy Solution” Shpk	16,581,973 I skualifikuar

II.4. Në datën 09.01.2026, operatori ekonomik “HTM” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij, në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Operatori nuk ploteson specifikimet teknike si me poshte :

1- Për Konektor fotovoltai i tipit Single Contact Eshte Kerkuar : Tension nominal (U_{rated}) 1500 V DC Eshte Deklaruar ne katalog : Tensioni I vleresuar : 1000V -Eshte Kerkuar : Klasifikim izolimi Class II, touch proof (IP2X) -Eshte Deklaruar ne katalog : Class II -Eshte Kerkuar :(rezistent ndaj UV) Mungon si e dhene teknike ne katalogun e deklaruar.

2-Sistemi i monitorimit dhe menaxhimit nuk ploteson specifikimet teknike si me poshte - Kontrollim (jep komande) - jo -Inverterat (ndeje/fikje). - jo -Gjenerimi i Raporteve - jo -Ditore, mujore dhe vjetore (by default).- jo -Raportet te gjenerohen ne format ".xlsx" dhe ".pdf" dhe te ruhen ne njehapesire memorie lehtësisht te aksesueshme nga përdoruesi. - jo -Standardet IEC 104S / IEC 61850 ose ekuivalente – jo.

3-Kriteret Teknike për Sistemin e Monitorimit dhe Menaxhimit -Duhet të jetë stacion stand-alone për kontroll me rreth të mbyllur dhe të hapur, optimizim dhe monitorim funksionesh.- jo -Duhet të mbështesë minimumi 3 rrethe kontrolli për ngrohje ose 2 rrethe kontrolli për ventilim, me mundësi zgjerimi përmes objekteve harduerike dhe softuerike. - jo -Duhet të ketë funksione PLC, të lira dhe si makro fikse (objekte harduerike) . - jo -Duhet të ketë objekte softuerike për rritje të efikasitetit energjetik dhe optimizim energjie. - jo Komunikimi -Duhet të ketë funksion të integruar të kontrollit në distancë përmes PC-së me shfletues pa nevojë për softëare shtesë ose përmes pajisjeve mobile. - jo -Duhet të mbështesë BACnet natyror sipas standardit DIN EN ISO 16484-5, nëpërmjet BACnet IP dhe BACnet MS/TP. – jo - Duhet të mbështesë komunikim dhe shkëmbim të dhënash dykahëshe me deri në 99 stacione automatizimi. – jo.

4- Ndërfaqet dhe bus-et -Duhet të ketë minimumi 2 bus-e (bazuar në CAN) të konfigurueshme si bus kabineti elektrik ose bus fushe, për lidhje me module fushore ose module kabineti elektrik. – jo.

5-Funksionaliteti dhe siguria - Duhet të mundësojë dërgim të mesazheve përmes GSM-SMS dhe e-mail. - jo -Duhet të ketë memorie trendesh për minimumi 10.000 pika trendesh. - jo -

Konfigurimi duhet të bëhet përmes strukture moderne objektuale, që redukton ndjeshëm kohën e projektimit. - jo -Sistemi duhet të bazohet në sistem operativ Linux të integruar, për funksionim të qëndrueshëm dhe të provuar. - jo -Duhet të garantojë monitorim të vazhdueshëm të komunikimit në bus dhe të gjithë komponentëve të lidhur DDC, me mundësi shkëmbimi dykahësh të të dhënave. - jo 5-Kriteret Teknike – Të dhënat teknike të pajisjes -Lidhjet e bus-it / ndërfaqet e komunikimit -2x Ethernet RJ45 me sëitch të brendshëm: - jo -Mbështet deri në 99 stacione automatizimi. -jo -Mundëson rrjet global përmes komponentëve aktivë të rrjetit. -jo -Lidhje me BMS dhe klientë BACnet. - jo -2x CAN bus, të konfigurueshme si: - jo -Bus fushe (F-bus): deri në 8 module fushore (FBM/FBU) dhe shtesë deri në 8 RBĒ4xxx. -jo -Gjatësi max kabllo: 2000 m. -jo -Shpejtësi: 20 kBd. -jo -Protokoll: CAN. -jo -Bus kabineti elektrik (SBM-bus): deri në 4 module kabineti (SBM ose BMA/BMD). -jo -Gjatësi max kabllo: 200 m. - jo -Shpejtësi: 40 kBd. -jo -Protokoll: CAN. -jo -1x USB: vetëm për USB stick, përditësim firmëare, backup dhe rikthim konfigurimi. -jo -2x RS232: -jo -1 port dedikuar për modem. -jo -2x RS485: -jo -1 port për komunikim BACnet MS/TP. -jo -Mbështetje deri në 32 pajisje. -jo -Gjatësi max kabllo: 1000 m.-jo -Shpejtësi deri në 115 kBd. -jo -Mundësi routing sipas BACnet/IP. -jo.

6-Memoria dhe Sistemi Operativ -Memorie totale: 4 GB Flash. -jo -Memorie RAM: 512 MB. - jo -Sistemi operativ: Embedded Linux. -jo -Siguria dhe mbrojtja -Ruajtje e të dhënave në rast të ndërprerjes së energjisë përmes mini-USV të brendshme. -jo. -Kategoria e mbivoltazhit: III. -jo -Tensioni i impulseve të vlerësuar: 800 V. -jo -Niveli i ndotjes: 2. -jo -Metoda e funksionimit: Tipi 1. -jo.

II.5. Në datën 26.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 10 datë 02.02.2026, ku është shpallur fitues OE “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk.

II.6. Në datën 03.02.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6302, si dhe nr. protokoli 335/2026 datë 03.02.2026 e operatorit ekonomik “HTM” Shpk, për procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “HTM” Shpk, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE “LAVIVA TECHNOLOGIES” SHPK, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 335/1 prot., datë 03.02.2026, me arsyet e skualifikimit dhe pretendimin që operatori ekonomik “HTM” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 335/2026 prot, datë 03.02.2026.

II.8. Me shkresën nr. 335/2 prot., datë 16.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “HTM” SHPK si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 612 prot., datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 335/3 prot., datë 18.02.2026, me objekt “*Kthim përgjigje ankesës online nr.aplikimi A2026/6302, datë 03.02.2026*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor, akti i trajtimit të ankesës ku kemi një **pranim pjesor** të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK, ku KSHA ka vendosur në përfundim:

1. *Skualifikimin e ofertës së ankimuesit “HTM” SHPK.*
2. *Skualifikim të ofertës së “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk.*

I. Paragrafi 1 – Mbi ankesën për skualifikimin e ofertës së ankimuesit „HTM shpk“.

1. *Për Konektor fotovoltaik i tipit Single Contact Eshte Kerkuar : Tension nominal (Urated) 1500 V , DC Eshte Deklaruar ne katalog ; Tensioni I vleresuar : 1000V -Eshte Kerkuar Class II -Eshte Kerkuar :(rezistent ndaj UV) Mungon si e dhene teknike ne katalogun e deklaruar.*

KSHA:

Nisur nga argumentimi i OE ankimues „HTM shpk“ dhe shqyrtimit të verifikimit të specifikimeve teknike të DST, KSHA konkludoi që **pika 1 e ankesës pranohet.**

II. Paragrafi 2 – Mbi ankesën për shpalljen e operatorit ekonomik fitues „Laviva Technologies shpk“.

1. Nuk Përmbush Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit:

Në kuadër të shqyrtimit të vendimit për shpalljen e operatorit ekonomik fitues, parashtrojmë këtë ankesë, pasi nga verifikimi i dokumentacionit zyrtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB): Rezulton se subjekti i shpallur fitues, me emërtim LAVIVA TECHNOLOGIES SHPK, me NIPT M01323012A bashkë me subjektin mbështetës “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H; Nuk kanë në objektin e veprimtarisë - Integrimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, në veçanti sistemet fotovoltaike, ashtu siç kërkohet nga objekti i kësaj procedure prokurimi, të cilat kërkojnë kompetencë të posaçme teknike dhe përvojë të dokumentuar.

KSHA:

Nga verifikimi i ekstraktit QKR të ofruesit „Laviva Technologies shpk“ në seksionin „Objekti i Aktivitetit“ të këtij dokumenti në QKB rezulton ndër të tjera dhe objekti i veprimtarisë „Furnizime dhe instalime Panele diellore për energji elektrike“, ndërsa subjekti mbështetës „Toëer shpk“ nuk rezulton të ketë objekt veprimtarie projektimin për energji të rinovueshme por disponon licensë në projektim me nr.5734/19 me datë vlefshmërie deri në 13.12.2026 me pikë license kategoria 10, pika C – Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, *kështu që Pika II/1 e ankesës nuk pranohet.*

2. Nuk Përmbush Kriteret e Veçanta të kualifikimit:

Për pikën 2.3.1 të Kushteve të Veçanta të Kualifikimit, plotësimin e Kapacitetit Teknik, nga verifikimi dhe monitorimi i kontratave për punë të ngjashme të deklaruara nga operatori ekonomik i shpallur fitues, rezulton se **ky operator nuk disponon kontrata të ngjashme që lidhen me punime në fushën e energjisë së rinovueshme, në veçanti me projektimin, furnizimin, instalimin apo integrimin e sistemeve fotovoltaike.** Kontratat e deklaruara nga “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NIPT M01323012A, me Subjekt Mbështetës “C O L O M B O” Shpk, me NIPT J82916489E & “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H, ky operator i referohen kryesisht punimeve dhe shërbimeve në fusha të tjera teknike, të ndryshme nga objekti i kësaj procedure prokurimi, dhe **nuk përbëjnë prova të përvojës së ngjashme në realizimin e sistemeve fotovoltaike apo integrimin e pajisjeve kyçe të tyre, siç janë inverterët fotovoltaike dhe komponentët përkatës të monitorimit dhe menaxhimit të energjisë.**

Në këtë kuadër, operatori ekonomik i shpallur fitues **nuk plotëson kriterin e përvojës së mëparshme në punë të ngjashme**, i cili është një kriter thelbësor për garantimin e aftësisë teknike dhe profesionale për realizimin e objektit të kontratës. Shpallja e tij fitues, në mungesë të kontratave të ngjashme në fushën e energjisë së rinovueshme dhe sistemeve fotovoltaike, bie ndesh me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.

KSHA:

Në SPE vërehet që është ngarkuar dokumenti me emertësë “15 Furnizimet e ngjashme.pdf (205.9 kb)”, Fatura e fiskalizuar me sukses me nr. 439/2025 datë 29.09.2025 ora 12:18:49 dhe fatura nr. 233/2025 datë 08.07.2025 ora 13:37:01, ku OE Laviva Technologies i ka shitur subjektit Instant.al me nuis L81506043D dhe subjektit AlbaScan me nuis L71416010E, artikujt si më poshtë:

Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	
Nr.	Njësia e Matjes
Sasia	
Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	
1	Copë
1	Module fotovoltaik
2	Copë
1	Inverter
3	Copë
1	Kabeli Elektrik i Kompletuar dhe Materiali Elektrik
4	Copë
1	Sistem monitorimi BMS
5	Copë
1	Instalimi, testimi dhe shërbimi i sistemit të punës së përbashkët
6	Copë
1	

Fatura nr. 439/2025

Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	
Nr.	Njësia e Matjes
Sasia	
Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	
1	Copë
1	

Fatura nr. 233/2025

KSHA:

Në faturën me nr. 439/2025 zëri nr.5 „Sistem Monitorimi BMS“ nuk përputhet me objektin e kontratës e cila është „Blerja dhe instalimi i paneleve diellore“.

Në faturën me nr. 233/2025 zëri i vetëm i shitur me nr. 1 „Sistem B.M.S (Building Management System)“ nuk përputhet me objektin e kontratës e cila është „Blerja dhe instalimi i paneleve diellore“ kështu që kjo faturë nuk konsiderohet punë e ngjashme.

Për sa më sipër, zërat 1-4 dhe zëri 6 i faturës me nr. 439/2025 që në vlerë totale 1,463,250 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tremijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh nuk arrijnë përmbush kriterin nr. 2.3.1 të Kushteve të Veçanta të Kualifikimit, ku është përcaktuar masa e punëve të ngjashme prej 10% (1,777,782 lekë pa tvsh) të fondit limit prej 17,777,820 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

Kështu që, KSHA **pranon II/2 të ankesës.**

- Për pikën 2.3.2 të Kushteve të Veçanta të Kualifikimit, Certifikimi i Operatorit Ekonomik për realizimin e projektit, subjekti i shpallur fitues, **“LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NIPT M01323012A, me Subjekt Mbështetës “C O L O M B O” Shpk, me NIPT J82916489E & “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H; Nuk disponohet :Certifikata ISO 14001:2015: Sistemi i Menaxhimit Mjedisor - e vlefshme ose ekuivalente; Certifikata ISO 50001:2018: Sistemi i Menaxhimit të Energjisë- e vlefshme ose ekuivalente.**

KSHA:

Nga shqyrtimi i ankesës, KSHA vërejtë që objekti i veprimtarisë së certifikatave ISO të ngarkuara në sistem nga OE Laviva Technologies, në cilësinë e OE garues, me nr. AQS/A/109382023 – ISO 14001:2015 dhe me nr. AQS/GE/137012025 – ISO 50001:2018, nuk përputhen me objektin e procedurës së prokurimit „Blerja dhe instalimi i paneleve fotovoltaike“.

Kështu që, KSHA **pranon II/3 të ankesës.**

- Për pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të Kushteve të Veçanta të Kualifikimit, licencimit profesional, subjekti i shpallur fitues, **“LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NIPT M01323012A,**

me Subjekt Mbështetës “C O L O M B O” Shpk, me NIPT J82916489E & “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H;

Nuk disponohet licencë profesionale të vlefshme për zbatimin e punimeve

NP-10 A – Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike

Nuk disponohet licencë projektimi

3.d – Vlerësim i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse;

4.c – Projektim i linjave dhe rrjeteve elektrike për objekte civile dhe industriale;

10.c – Projektim i impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme;

10.e – Projektim i kabinave elektrike të rrjetit shpërndarës, linja të tensionit të ulët dhe të mesëm.

Në mendimin tonë operatori mbështetës “TOËER” Shpk, me NIPT L21717003H, ka marrë përsipër projektimin, ndërkohe pikat e licencës të kërkuara në DST nuk i plotëson.

Si perfundim, Subjekti i shpallur fitues, “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NIPT M01323012A, me Subjekt Mbështetës “C O L O M B O” Shpk, me NIPT J82916489E & “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H:

Eshtë mbështetur në një masë dominuese, konkretisht mbi 50%, në kapacitetet njerëzore teknike dhe inxhinierike të subjekteve të treta.

Bazuar në VKM 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, pika 2 ku citohet: [...] Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor [...] gjithashtu mbështetur në Vendimin e KPP Nr.288/2024, datë 06.03.2024, Nr. 2969/15 Prot., datë 06.03.2024, faqe 115, 116, ku shprehimisht thuhet se : “1.Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

Gjykojmë se mbështetja është e pabazuar në stafin Teknik profesional, sepse në rastet kur një operator ekonomik nuk disponon kapacitetet thelbësore teknike dhe inxhinierike të kërkuara, legjislacioni për prokurimin publik parashikon si zgjidhje të ligjshme bashkimin e operatorëve ekonomikë (bashkim operatorësh / joint venture), duke siguruar kështu përgjegjësi të qartë kontraktuale dhe aftësi reale për zbatimin e kontratës, dhe jo mbështetjen e tepruar në staf të huazuar nga subjekte të treta.

KSHA:

Nga shqyrtimi i ankesës së OE „HTM shpk“ për kualifikim të padrejtë të OE „Laviva Technologies shpk“, vlerësojmë se pikat e licensës së kërkuar si më poshtë:

NP-10 A – Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike...disponohet nga subjekti mbështetës i deklaruar „Colombo shpk“ me nr. License NZ.0021/18 datë vlefshmërie 05.02.2028, licensë për zbatimin e punimeve të procedurës së kërkuar.

3.d – Vlerësim i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse;
4.c – Projektim i linjave dhe rrjeteve elektrike për objekte civile dhe industriale;
10.c – Projektim i impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme;
10.e – Projektim i kabinave elektrike të rrjetit shpërndarës, linja të tensionit të ulët dhe të mesëm....disponohen nga subjekti mbështetës “Toëer shpk” me nr. License 5734/19 datë vlefshmërie 13.12.2026, licensë për projektim dhe studim të procedurës së kërkuar.

Për sa m sipër, ankesa e ankimuesit “HTM shpk” për tejkalimin e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera prej 50% të kërkesave të përcaktuara nga AK, **pranohet, pasi vërehet që licensën për projektimin e kontratës/procedurës “Procedurë e Hapur-Kontratë me Celësa në Dorë” e disponon 100% subjekti mbështetës “Tower shpk” dhe licensën për zbatimin dhe instalimin e kontratës/procedurës e disponon 100% subjekti mbështetës “Colombo shpk”.**

Në konkludim , KSHA vendos:

1. Skualifikimin e ofertës së ankimuesit **HTM shpk** me nuis K97006004D me ofertë ekonomike **13,333,365.00** (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lek pa tvsh.
2. Skualifikimin e ofertës së **Laviva shpk** me nuis M01323012A me ofertë në vlerën ekonomike **16,400,000** (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind mijë) lek pa tvsh.

II.10. Nga shqyrtimi i ankesës rezulton, se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e KVO-se mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “HTM” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 23 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore, në mjediset e institucionit tonë, me përfaqësues ekspert fushe të *operatorit ekonomik “HTM” SHPK* si dhe përfaqësues ekspert fushe, anëtarë të njesisë së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nga ana e autoritetit kontraktor, të cilët ka qenë pjesë e grupit të punës të ngritur për vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Për këtë qëllim iu drejtua me shkresën nr. 335/4 prot., datë 18.02.2026, operatorit ekonomik ankimus “HTM” SHPK dhe autoritetit kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, për t’u paraqitur në seancë dëgjimore pranë ambienteve të KPP-së, ditën e hënë, datë 23.02.2026 ora 12:00.

II.11. Nëpërmjet shkresës me nr. 629/1 prot., datë 18.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 335/5 prot., datë 18.02.2026, me objekt “Kthim përgjigje ankesës online nr.aplikimi A2026/6302, datë 03.02.2026”, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni i kërkuar.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

II.13. Në seancën dëgjimore të datës 23.02.2026 të zhvilluar në mjediset e KPP-së në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, u paraqitën përfaqësuesit e operatorit ekonomik

“HTM” ShPK (Z. I.T, Z. L,D,) dhe përfaqësues nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, Z. A, Ç, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Përfaqësuesit e operatorit ekonomik ankimues dhe të autoritetit kontraktor nuk kishin ndonjë kontestim gjatë seancës dëgjimore. Seanca dëgjimore u regjistrua në audio.

II.14. Nëpërmjet komunikimit të postës elektronike (info_kpp.gov.al), në adresën zyrtare të KPP-së, operatori ekonomik ankimues “HTM” shpk, ka dërguar argumenta mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të mallit objekt prokurimi, të protokolluar me tonën me nr. 335/6 prot., datë 25.02.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës me nr. 612 prot., datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 335/3 prot., datë 18.02.2026, me objekt “*Kthim përgjigje ankesës online nr.aplikimi A2026/6302, datë 03.02.2026*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor, akti i trajtimit të ankesës ku kemi një **pranim pjesor** të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK, ku KSHA ka vendosur në përfundim:

1. *Skualifikimin e ofertës së ankimuesit “HTM” SHPK.*
2. *Skualifikim të ofertës së “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk.*

I. Paragrafi 1 – Mbi ankesën për skualifikimin e ofertës së ankimuesit „HTM shpk“.

1. *Për Konektor fotovoltaiik i tipit Single Contact Eshte Kerkuar : Tension nominal (Urated) 1500 V , DC Eshte Deklaruar ne katalog : Tensioni I vleresuar : 1000V -Eshte Kerkuar Class II -Eshte Kerkuar :(rezistent ndaj UV) Mungon si e dhene teknike ne katalogun e deklaruar.*

KSHA:

Nisur nga argumentimi i OE ankimues „HTM shpk“ dhe shqyrtimit të verifikimit të specifikimeve teknike të DST, KSHA konkludoi që **pika 1 e ankesës pranohet.**

II. Paragrafi 2 – Mbi ankesën për shpalljen e operatorit ekonomik fitues „Laviva Technologies shpk“.

1. Nuk Përmbush Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit:

Në kuadër të shqyrtimit të vendimit për shpalljen e operatorit ekonomik fitues, parashtrojmë këtë ankesë, pasi nga verifikimi i dokumentacionit zyrtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB): Rezulton se subjekti i shpallur fitues, me emërtim LAVIVA TECHNOLOGIES SHPK, me NIPT M01323012A bashkë me subjektin mbështetës “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H; Nuk kanë në objektin e veprimtarisë - Integrimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, në veçanti sistemet fotovoltaike, ashtu siç kërkohet nga objekti i kësaj procedure prokurimi, të cilat kërkojnë kompetencë të posaçme teknike dhe përvojë të dokumentuar.

KSHA:

Nga verifikimi i ekstraktit QKR të ofruesit „Laviva Technologies shpk“ në seksionin „Objekti i Aktivitetit“ të këtij dokumenti në QKB rezulton ndër të tjera dhe objekti i veprimtarisë „Furnizime dhe instalime Panele diellore për energji elektrike“, ndërsa subjekti mbështetës „Toëer shpk“ nuk rezulton të ketë objekt veprimtarie projektimin për energji të rinovueshme por disponon licensë në projektim me nr.5734/19 me datë vlefshmërie deri në 13.12.2026 me pikë license kategoria 10, pika C – Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, *kështu që Pika II/1 e ankesës nuk pranohet.*

2. Nuk Përmbush Kriteret e Veçanta të kualifikimit:

Për pikën 2.3.1 të Kushteve të Veçanta të Kualifikimit, plotësimin e Kapacitetit Teknik, nga verifikimi dhe monitorimi i kontratave për punë të ngjashme të deklaruara nga operatori ekonomik i shpallur fitues, rezulton se **ky operator nuk disponon kontrata të ngjashme që lidhen me punime në fushën e energjisë së rinovueshme, në veçanti me projektimin, furnizimin, instalimin apo integrimin e sistemeve fotovoltaike.** Kontratat e deklaruara nga “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NIPT M01323012A, me Subjekt Mbështetës “C O L O M B O” Shpk, me NIPT J82916489E & “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H, ky operator i referohen kryesisht punimeve dhe shërbimeve në fusha të tjera teknike, të ndryshme nga objekti i kësaj procedure prokurimi, dhe **nuk përbëjnë prova të përvojës së ngjashme në realizimin e sistemeve fotovoltaike apo integrimin e pajisjeve kyçe të tyre, siç janë inverterët fotovoltaike dhe komponentët përkatës të monitorimit dhe menaxhimit të energjisë.**

Në këtë kuadër, operatori ekonomik i shpallur fitues **nuk plotëson kriterin e përvojës së mëparshme në punë të ngjashme**, i cili është një kriter thelbësor për garantimin e aftësisë teknike dhe profesionale për realizimin e objektivit të kontratës. Shpallja e tij fitues, në mungesë të kontratave të ngjashme në fushën e energjisë së rinovueshme dhe sistemeve fotovoltaike, bie ndesh me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.

KSHA:

Në SPE vërehet që është ngarkuar dokumenti me emertësë “15 Furnizimet e ngjashme.pdf (205.9 kb)”, Fatura e fiskalizuar me sukses me nr. 439/2025 datë 29.09.2025 ora 12:18:49 dhe fatura nr. 233/2025 datë 08.07.2025 ora 13:37:01, ku OE Laviva Technologies i ka shitur subjektit Instant.al me nuis L81506043D dhe subjektit AlbaScan me nuis L71416010E, artikujt si më poshtë:

Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	
Nr.	Njësia e Matjes
Sasia	
Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	
1	Copë
1	Module fotovoltaik
2	Copë
1	Inverter
3	Copë
1	Kabeli Elektrik i Kompletuar dhe Materiali Elektrik
4	Copë
1	Sistem monitorimi BMS
5	Copë
1	Instalimi, labori dhe shërbime të tjera të përfshira në krah të instalimit dhe shërbimeve të tjera
6	Copë
1	

Fatura nr. 439/2025

Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	
Nr.	Njësia e Matjes
Sasia	
Përshkrimi i Mallit ose Shërbimit	
1	Copë
1	Sistem B.M.S (Building Management System)

Fatura nr. 233/2025

KSHA:

Në faturën me nr. 439/2025 zëri nr.5 „Sistem Monitorimi BMS“ nuk përputhet me objektin e kontratës e cila është „Blerja dhe instalimi i paneleve diellore“.

Në faturën me nr. 233/2025 zëri i vetëm i shitur me nr. 1 „Sistem B.M.S (Building Management System)“ nuk përputhet me objektin e kontratës e cila është „Blerja dhe instalimi i paneleve diellore“ kështu që kjo faturë nuk konsiderohet punë e ngjashme.

Për sa më sipër, zërat 1-4 dhe zëri 6 i faturës me nr. 439/2025 që në vlerë totale 1,463,250 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tremijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh nuk arrijnë përmbush kriterin nr. 2.3.1 të Kushteve të Veçanta të Kualifikimit, ku është përcaktuar masa e punëve të ngjashme prej 10% (1,777,782 lekë pa tvsh) të fondit limit prej 17,777,820 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

Kështu që, KSHA **pranon II/2 të ankesës**.

- Për pikën 2.3.2 të Kushteve të Veçanta të Kualifikimit, Certifikimi i Operatorit Ekonomik për realizimin e projektit, subjekti i shpallur fitues, **“LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NIPT M01323012A, me Subjekt Mbështetës “C O L O M B O” Shpk, me NIPT J82916489E & “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H; Nuk disponohet :Certifikata ISO 14001:2015: Sistemi i Menaxhimit Mjedisor - e vlefshme ose ekuivalente; Certifikata ISO 50001:2018: Sistemi i Menaxhimit të Energjisë- e vlefshme ose ekuivalente.**

KSHA:

Nga shqyrtimi i ankesës, KSHA vërejtë që objekti i veprimtarisë së certifikatave ISO të ngarkuara në sistem nga OE Laviva Technologies, në cilësinë e OE garues, me nr. AQS/A/109382023 – ISO 14001:2015 dhe me nr. AQS/GE/137012025 – ISO 50001:2018, nuk përputhen me objektin e procedurës së prokurimit „Blerja dhe instalimi i paneleve fotovoltaike“.

Kështu që, KSHA **pranon II/3 të ankesës**.

- Për pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të Kushteve të Veçanta të Kualifikimit, licencimit profesional, subjekti i shpallur fitues, **“LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NIPT M01323012A,**

me Subjekt Mbështetës “C O L O M B O” Shpk, me NIPT J82916489E & “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H;

Nuk disponohet licencë profesionale të vlefshme për zbatimin e punimeve

NP-10 A – Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike

Nuk disponohet licencë projektimi

3.d – Vlerësim i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse;

4.c – Projektim i linjave dhe rrjeteve elektrike për objekte civile dhe industriale;

10.c – Projektim i impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme;

10.e – Projektim i kabinave elektrike të rrjetit shpërndarës, linja të tensionit të ulët dhe të mesëm.

Në mendimin tonë operatori mbështetës “TOËER” Shpk, me NIPT L21717003H, ka marrë përsipër projektimin, ndërkohe pikat e licencës të kërkuara në DST nuk i plotëson.

Si perfundim, Subjekti i shpallur fitues, “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NIPT M01323012A, me Subjekt Mbështetës “C O L O M B O” Shpk, me NIPT J82916489E & “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H:

Eshtë mbështetur në një masë dominuese, konkretisht mbi 50%, në kapacitetet njerëzore teknike dhe inxhinierike të subjekteve të treta.

Bazuar në VKM 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, pika 2 ku citohet: [...] Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor [...] gjithashtu mbështetur në Vendimin e KPP Nr.288/2024, datë 06.03.2024, Nr. 2969/15 Prot., datë 06.03.2024, faqe 115, 116, ku shprehimisht thuhet se : “1.Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

Gjykojmë se mbështetja është e pabazuar në stafin Teknik profesional, sepse në rastet kur një operator ekonomik nuk disponon kapacitetet thelbësore teknike dhe inxhinierike të kërkuara, legjislacioni për prokurimin publik parashikon si zgjidhje të ligjshme bashkimin e operatorëve ekonomikë (bashkim operatorësh / joint venture), duke siguruar kështu përgjegjësi të qartë kontraktuale dhe aftësi reale për zbatimin e kontratës, dhe jo mbështetjen e tepruar në staf të huazuar nga subjekte të treta.

KSHA:

Nga shqyrtimi i ankesës së OE „HTM shpk“ për kualifikim të padrejtë të OE „Laviva Technologies shpk“, vlerësojmë se pikat e licensës së kërkuar si më poshtë:

NP-10 A – Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike...disponohet nga subjekti mbështetës i deklaruar „Colombo shpk“ me nr. License NZ.0021/18 datë vlefshmërie 05.02.2028, licensë për zbatimin e punimeve të procedurës së kërkuar.

3.d – Vlerësim i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse;
 4.c – Projektim i linjave dhe rrjeteve elektrike për objekte civile dhe industriale;
 10.c – Projektim i impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme;
 10.e – Projektim i kabinave elektrike të rrjetit shpërndarës, linja të tensionit të ulët dhe të mesëm....disponohen nga subjekti mbështetës “Toëer shpk” me nr. License 5734/19 datë vlefshmërie 13.12.2026, licensë për projektim dhe studim të procedurës së kërkuar.

Për sa m sipër, ankesa e ankimesit “HTM shpk” për tejkalimin e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera prej 50% të kërkesave të përcaktuara nga AK, **pranohet, pasi vërehet që licensën për projektimin e kontratës/procedurës “Procedurë e Hapur-Kontratë me Celësa në Dorë” e disponon 100% subjekti mbështetës “Tower shpk” dhe licensën për zbatimin dhe instalimin e kontratës/procedurës e disponon 100% subjekti mbështetës “Colombo shpk”.**

Në konkludim , KSHA vendos:

1. Skualifikimin e ofertës së ankimesit **HTM shpk** me nuis K97006004D me ofertë ekonomike **13,333,365.00** (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lek pa tvsh.
2. Skualifikimin e ofertës së **Laviva shpk** me nuis M01323012A me ofertë në vlerën ekonomike **16,400,000** (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind mijë) lek pa tvsh.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
 ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i

afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Për sa më sipër citur, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar dhe do të vazhdojë shqyrtimin për pjesën tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se:

- “2-Sistemi i monitorimit dhe menaxhimit nuk ploteson specifikimet teknike si me poshte -*
- Kontrollim (jep komande) - jo*
- Inverterat (ndeje/fikje). - jo*
- Gjenerimi i Raporteve - jo*
- Ditore, mujore dhe vjetore (by default).- jo*
- Raportet te gjenerohen ne format ".xlsx" dhe ".pdf" dhe te ruhen ne njehapesire memorie lehtësisht te aksesueshme nga përdoruesi. - jo*
- Standardet IEC 104S / IEC 61850 ose ekuivalente – jo.*

3-Kriteret Teknike për Sistemin e Monitorimit dhe Menaxhimit

- Duhet të jetë stacion stand-alone për kontroll me rreth të mbyllur dhe të hapur, optimizim dhe monitorim funksionesh.- jo*
- Duhet të mbështesë minimumi 3 rrethe kontrolli për ngrohje ose 2 rrethe kontrolli për ventilim, me mundësi zgjerimi përmes objekteve harduerike dhe softuerike. - jo*
- Duhet të ketë funksione PLC, të lira dhe si makro fikse (objekte harduerike) . -jo*
- Duhet të ketë objekte softuerike për rritje të efikasitetit energjetik dhe optimizim energjie. - jo*

Komunikimi

- Duhet të ketë funksion të integruar të kontrollit në distancë përmes PC-së me shfletues pa nevojë për softëare shtesë ose përmes pajisjeve mobile. - jo*
- Duhet të mbështesë BACnet natyror sipas standardit DIN EN ISO 16484-5, nëpërmjet BACnet IP dhe BACnet MS/TP. – jo*
- Duhet të mbështesë komunikim dhe shkëmbim të dhënash dykahëshe me deri në 99 stacione automatizimi. – jo.*

4- Ndërfaqet dhe bus-et

- Duhet të ketë minimumi 2 bus-e (bazuar në CAN) të konfigurueshme si bus kabineti elektrik ose bus fushe, për lidhje me module fushore ose module kabineti elektrik. – jo.*

5-Funksionaliteti dhe siguria

- Duhet të mundësojë dërgim të mesazheve përmes GSM-SMS dhe e-mail. - jo*
- Duhet të ketë memorie trendesh për minimumi 10.000 pika trendesh. - jo*
- Konfigurimi duhet të bëhet përmes strukture moderne objektuale, që redukton ndjeshëm*

kohën e projektimit. - jo

-Sistemi duhet të bazohet në sistem operativ Linux të integruar, për funksionim të qëndrueshëm dhe të provuar. - jo

-Duhet të garantojë monitorim të vazhdueshëm të komunikimit në bus dhe të gjithë komponentëve të lidhur DDC, me mundësi shkëmbimi dykahësh të të dhënave. - jo

5-Kriteret Teknike – Të dhënat teknike të pajisjes

-Lidhjet e bus-it / ndërfaqet e komunikimit

-2x Ethernet RJ45 me sëitch të brendshëm: - jo

-Mbështet deri në 99 stacione automatizimi. -jo

-Mundëson rrjet global përmes komponentëve aktivë të rrjetit. -jo

-Lidhje me BMS dhe klientë BACnet. - jo

-2x CAN bus, të konfigurueshme si: - jo

-Bus fushe (F-bus): deri në 8 module fushore (FBM/FBU) dhe shtesë deri në 8 RBĒ4xxx. -jo

-Gjatësi max kabllo: 2000 m. -jo

-Shpejtësi: 20 kBd. -jo

-Protokoll: CAN. -jo

-Bus kabineti elektrik (SBM-bus): deri në 4 module kabineti (SBM ose BMA/BMD). -jo -

Gjatësi max kabllo: 200 m. - jo

-Shpejtësi: 40 kBd. -jo

-Protokoll: CAN. -jo

-1x USB: vetëm për USB stick, përditësim firmëare, backup dhe rikthim konfigurimi.-jo

-2x RS232: -jo

-1 port dedikuar për modem. -jo

-2x RS485: -jo

-1 port për komunikim BACnet MS/TP. -jo

-Mbështetje deri në 32 pajisje. -jo

-Gjatësi max kabllo: 1000 m.-jo

-Shpejtësi deri në 115 kBd. -jo

-Mundësi routing sipas BACnet/IP. -jo.

6-Memoria dhe Sistemi Operativ

-Memorie totale: 4 GB Flash. -jo

-Memorie RAM: 512 MB. -jo

-Sistemi operativ: Embedded Linux. -jo

-Siguria dhe mbrojtja -Ruajtje e të dhënave në rast të ndërprerjes së energjisë përmes mini-USV të brendshme. -jo.

-Kategoria e mbivoltazhit: III. -jo

-Tensioni i impulseve të vlerësuar: 800 V. -jo

-Niveli i ndotjes: 2. -jo

-Metoda e funksionimit: Tipi 1. -jo”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika

2.3.16 Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

” Specifikimet Teknike për blerjen dhe instalimin e Paneleve Fotovoltaike ”

1.7.Panelet Elektrike, Kabujt AC dhe DC

1.7.6.Monitorimin i Energjisë

Qëllimi i ndërtimit është monitorimi dhe kontrolli i impiantit fotovoltaike. Modulet kryesore qe Sistemi i Monitorimit do te monitoroje dhe kontrolloje janë:

- Siguria Teknike
- Prodhimi i energjisë elektrike

Funksionet qe do te kryeje Sistemi i Monitorimit:

- a) Monitorim
 - Parametrat elektrik te inverterave.
 - Monitorim i vargjeve dhe identifikim i tyre ne raste problematikash.
 - Alarmet e sistemit, ku te afishohen duke pershkruar tipin e alarmit, identifikimin ku ndodhi si dhe rekomandimet per zgjidhje.
 - Matesit e energjise elektrike.
- b) Kontrollim (jep komande)
 - Inverterat (ndeze/fikje).
- c) Gjenerimi i Raporteve
 - Ditore, mujore dhe vjetore (by default).
 - Raportet te gjenerohen ne format ".xlsx" dhe ".pdf" dhe te ruhen ne njehapesire memorie lehtesisht te aksesueshme nga perdoruesi.
 - Standardet IEC 104S / IEC 61850 ose ekuivalente

Duhet të zbatohet Politika e Sigurisë Kibernetike për Sistemet e Kontrollit Industrial. Kontraktuesi do të sigurojë besueshmërinë, disponueshmërinë dhe performancën e sistemeve që do të implementohen për impiantin e ri FV siç përshkruhet në këtë specifikim. Kontraktori është përgjegjës për furnizimin e një pakete monitorimi plotësisht në përputhje me sistemin elektrik të impiantit FV.

Kriteret Teknike për Sistemin e Monitorimit dhe Menaxhimit

- Duhet të jetë stacion stand-alone për kontroll me rreth të mbyllur dhe të hapur, optimizim dhe monitorim funksionesh.
- Duhet të ofrojë mundësinë e përshtatjes së teksteve të thjeshta për çdo parametër.
- Duhet të mbështesë minimumi 3 rrethe kontrolli për ngrohje ose 2 rrethe kontrolli për ventilim, me mundësi zgjerimi përmes objekteve harduerike dhe softuerike.
- Duhet të ketë funksione PLC, të lira dhe si makro fikse (objekte harduerike).
- Duhet të ketë objekte softuerike për rritje të efikasitetit energjetik dhe optimizim energjie.

Komunikimi

- Duhet të mbështesë komunikim përmes TCP/IP, Ethernet (minimum Cat5, 10/100 Mbit) për përdorimin e infrastrukturës ekzistuese.
- Duhet të ketë funksion të integruar të kontrollit në distancë përmes PC-së me shfletues pa nevojë për softëare shtesë ose përmes pajisjeve mobile.

- Duhet të mbështesë BACnet natyror sipas standardit DIN EN ISO 16484-5, nëpërmjet BACnet IP dhe BACnet MS/TP.
- Duhet të mbështesë komunikim dhe shkëmbim të dhënash dykahëshe me deri në 99 stacione automatizimi.

-

Ndërfaqet dhe bus-et

- Duhet të ketë minimumi 2 bus-e (bazuar në CAN) të konfigurueshme si bus kabineti elektrik ose bus fushe, për lidhje me module fushore ose module kabineti elektrik.

Funksionaliteti dhe siguria

- Duhet të ketë memorie për ruajtjen e gabimeve, regjistrim ngjarjesh me datë dhe kohë, dhe ruajtje të mesazheve hyrëse dhe dalëse.
- Duhet të mundësojë dërgim të mesazheve përmes GSM-SMS dhe e-mail.
- Duhet të ketë memorie trendesh për minimumi 10.000 pika trendesh.
- Konfigurimi duhet të bëhet përmes strukture moderne objektuale, që redukton ndjeshëm kohën e projektimit.
- Sistemi duhet të bazohet në sistem operativ Linux të integruar, për funksionim të qëndrueshëm dhe të provuar.
- Duhet të garantojë monitorim të vazhdueshëm të komunikimit në bus dhe të gjithë komponentëve të lidhur DDC, me mundësi shkëmbimi dykahësh të të dhënave.

Kriteret Teknike – Të dhënat teknike të pajisjes

Furnizimi me energji

Tension nominal:

- 24 V AC $\pm 10\%$, 50–60 Hz, 20 VA, 0,83 A
- ose 24 V DC $\pm 10\%$, 13 W, 0,54 A
- ose 12 V DC $\pm 10\%$, 13 W, 1,08 A
- Siguresa: siguresë vonese (time-delay) 0,63 A.

Lidhjet e bus-it / ndërfaqet e komunikimit

2x Ethernet RJ45 me sëitch të brendshëm:

Mbështet deri në 99 stacione automatizimi.

Mundëson rrjet global përmes komponentëve aktivë të rrjetit.

Lidhje me BMS dhe klientë BACnet.

Shpejtësi 10/100 Mb/s, protokoll TCP/IP.

2x CAN bus, të konfigurueshme si:

Bus fushe (F-bus): deri në 8 module fushore (FBM/FBU) dhe shtesë deri në 8 RBĒ4xxx.

Gjatësi max kabllo: 2000 m.

Shpejtësi: 20 kBd.

Protokoll: CAN.

Bus kabineti elektrik (SBM-bus): deri në 4 module kabineti (SBM ose BMA/BMD).

Gjatësi max kabllo: 200 m.

Shpejtësi: 40 kBd.

Protokoll: CAN.

1x USB: vetëm për USB stick, përditësim firmëare, backup dhe rikthim konfigurimi.

2x RS232:

1 port dedikuar për modem.

2x RS485:

1 port për komunikim BACnet MS/TP.
Mbështetje deri në 32 pajisje.
Gjatësi max kablllo: 1000 m.
Shpejtësi deri në 115 kBd.
Mundësi routing sipas BACnet/IP.

Memoria dhe Sistemi Operativ

Memorie totale: 4 GB Flash.
Memorie RAM: 512 MB.
Sistemi operativ: Embedded Linux.
Siguria dhe mbrojtja
Ruajtje e të dhënave në rast të ndërprerjes së energjisë përmes mini-USV të brendshme.
Kategoria e mbivoltazhit: III.
Tensioni i impulseve të vlerësuar: 800 V.
Niveli i ndotjes: 2.
Metoda e funksionimit: Tipi 1.
Shkalla e mbrojtjes: IP20.
Kushtet mjedisore
Temperatura e ambientit gjatë punës: 0 ... +55 °C.
Lagështia e ambientit gjatë punës: 20 % ... 80 % RH, jo kondensuese.
Lagështia e ambientit jashtë punës: 5 % ... 90 % RH, jo kondensuese.
Montimi dhe instalimi
Montim në shina Hutschiene (top-hat rail) TH 35-7.5.
Pajisja është e destinuar për t'u instaluar në kabinet elektrik ose kasetë të montuar në mur me klasë mbrojtjeje I ose II.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “HTM” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Dokumenti me emërtimin “2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1”;
- Dokumenti me emërtimin “2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_2”;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën.

Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në

njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.8. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.2.9. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”

III.2.10. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.11. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren, se operatori ekonomik në lidhje me dokumentin me emërtimin “2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1pdf”, pretendon se:

“2- Sistemi i Menaxhimit dhe Monitorimit në Sungroë (Cloud-Based) Sistemi i monitorimit dhe menaxhimit nuk plotëson specifikimet teknike si me poshte -Kontrollim (jep komande) - jo - Inverterat (ndezj default).- jo Arsytimi Teknik : Sistemi i monitorimit dhe menaxhimit iCloud Solar është projektuar si një platformë me fleksibilitet të lartë për sistemet fotovoltaike, e cila ofron jo vetëm funksione monitorimi, por edhe funksione aktive kontrolli dhe menaxhimi të inverterëve, përfshirë dërgimin e komandave operative (ndezje/fikje start/stop). Në këtë kuadër, ne po ju paraqesim një shembull konkret të vërtetimit të këtij funksionaliteti, i cili

demonstron qartë aftësinë e sistemit për të kryer komandimin dhe menaxhimin e inverterve. Për rrjedhojë, pretendimi se sistemi i monitorimit dhe menaxhimit nuk plotëson kërkesën për kontroll dhe dhënie komandash ndaj inverterëve nuk qëndron. Raportet të gjenerohen në format .xlsx dhe .pdf dhe të ruhen në një hapësirë memorie lehtësisht të aksesueshme nga përdoruesi. Arsyetimi Teknik : Platforma e monitorimit dhe menaxhimit iCloud Solar mundëson gjenerimin e raporteve të cilat mund të eksportohen dhe të ruhen drejtpërdrejt në memorien e pajisjes nga e cila po aksesohet sistemi iCloud Solar (kompjuter, tablet apo smartphone). Këto raporte ruhen në një hapësirë memorie lehtësisht të aksesueshme nga përdoruesi, duke garantuar përdorim praktik, arkivim dhe shpërndarje të menjëhershme sipas nevojave operative. Serisht bashkëngjitur keni dhe shembullin se si mund të kryhet ky veprim në Sistemin e monitorimit

Standardet IEC 104/ IEC 61850 ose ekuivalente Arsyetimi Teknik : Në seksionin iCommunication, inverterët Sungrow mbështesin RS485 si ndërfaqe standarde komunikimi, si dhe WLAN dhe Ethernet si opsione shtesë. Nëpërmjet këtyre ndërfaqeve, inverterët Sungrow përdorin protokolle të standardizuara industriale, kryesisht Modbus RTU (RS485) dhe Modbus TCP/IP (Ethernet), si dhe profile SunSpec Modbus, të cilat mundësojnë monitorim në kohë reale, komandim të inverterëve (start/stop, kontroll i fuqisë aktive dhe reaktive, set-point-e) dhe integrim të plotë me sisteme SCADA, EMS dhe BMS. Standardet IEC 60870-5-104 dhe IEC 61850 janë standarde komunikimi për sistemet energjetike, të fokusuara në shkëmbimin e të dhënave, monitorim dhe komandim. Në këtë kontekst, Modbus RTU / Modbus TCP/IP dhe SunSpec Modbus, të përdorura nga Sungrow, ofrojnë funksionalitete ekuivalente për aplikimet fotovoltaike, duke përmbushur kërkesën funksionale për komunikim, menaxhim dhe kontroll të pajisjeve, edhe pse nuk janë identike në strukturë me standardet IEC të mësipërme. Për rrjedhojë, mënyra e komunikimit të inverterëve Sungrow, e bazuar në RS485 dhe Ethernet, si dhe protokollat përkatëse Modbus, përmbush kërkesën iEC 104 / IEC 61850 ose ekuivalente, në përputhje me parimin e ekuivalencës funksionale dhe neutralitetit teknologjik.

3- Kriteret Teknike për Sistem kontroll me rreth të mbyllur dhe të hapur

Inverterët Sungrow mbështesin komunikim të kablluar (wired communication) përmes RS485 dhe Ethernet, siç është deklaruar në seksionin Communication. Nëpërmjet këtyre ndërfaqeve, realizohet komunikim dykahësh me sistemet e monitorimit dhe menaxhimit, duke përdorur protokolle industriale të standardizuara Modbus RTU (RS485) dhe Modbus TCP/IP (Ethernet). Ky komunikim i kablluar mundëson monitorim në kohë reale, dërgim komandash operative (start/stop, kontroll i fuqisë aktive dhe reaktive, set-point-e) si dhe integrim me sisteme SCADA/EMS/BMS përmes rrjeteve Ethernet, pa kufizime nga komunikimi wireless. Në këtë kontekst, kërkesat për komunikim dhe shkëmbim dykahësh të të dhënave plotësohen përmes arkitekturës së komunikimit të kablluar të inverterëve Sungrow. Protokollat Modbus RTU / Modbus TCP/IP, të përdorura gjerësisht në sistemet energjetike dhe industriale, ofrojnë funksionalitete ekuivalente me standardet e komunikimit të kërkuara për monitorim dhe kontroll, në përputhje me parimin e ekuivalencës funksionale dhe neutralitetit teknologjik.

Baza Ligjore: iKërkesa që sistemi i komunikimit të jetë vetëm nëpërmjet një teknologjie/protokolli të caktuar, pa pranuar protokolle/ndërfaqe ekuivalente, bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit dhe përbën ngushtim artificial të konkurrencës (neni 3 i LPP). Specifikimet teknike duhet të mos shërbejnë si pengesa

për konkurrencën e hapur dhe mund/duhet të formulohen në terma funksionalë ose performance; çdo referencë duhet të shoqërohet me ose ekuivalente (neni 36 i LPP). Gjithashtu, ndalohet imponimi i një zgjidhjeje specifike (markë/burim/proces i veçantë) përveç rasteve të justifikuara plotësisht dhe në çdo rast me ose ekuivalente (neni 36/4 i LPP).

Në katalogun teknik të platformës iSolarCloud, është specifikuar qartë se sistemi mbështet integrimin dhe menaxhimin e një game të gjerë pajisjesh inteligjente, jo vetëm inverter. Konkretisht, përveç inverterëve, platforma mbështet EV charger, DVS, stacion meteorologjik, matës energjie elektrike, transformatorë, ndërprerës (circuit breakers) si dhe wother devices in the plant. Kjo dëshmon se arkitektura e sistemit është e hapur dhe e zgjerueshme, duke mundësuar komunikim, monitorim dhe menaxhim të pajisjeve të ndryshme përmes ndërfaqeve të standardizuara të komunikimit. Për rrjedhojë, pretendimi se sistemi i monitorimit dhe menaxhimit është i kufizuar ose nuk mbështet integrimin e pajisjeve të tjera nuk qëndron, pasi vetë dokumentacioni i prodhuesit parashikon shprehimisht mbështetjen për pajisje të tjera (other devices) në nivel impianti.

4- Ndërfaqet dhe bus kabineti elektrik ose bus fushe

Zgjidhja e propozuar bazohet në arkitekturë cloud, ku komunikimi realizohet përmes ndërfaqeve të standardizuara RS485 dhe Ethernet, pa nevojë për bus fushe ose module kabineti elektrik tipike për sistemet DDC/BMS. Kjo arkitekturë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për monitorim dhe menaxhim të sistemeve fotovoltaike.

Platforma iSolarCloud mundëson njoftime dhe alarme nëpërmjet e-mail dhe kanaleve cloud, duke siguruar informim në kohë reale të përdoruesit. Arkitektura cloud e iSolarCloud bazohet në modelim objektual të pajisjeve (inverterë, matës, pajisje të tjera), duke eliminuar nevojën për strukturë lokale të tipit për kontrollorët DDC. Kjo qasje redukton kohën e konfigurimit dhe është e përshtatshme për menaxhim energjie. Megjithëse terminologjia DDC i përket sistemeve HVAC/BMS, zgjidhja cloud iSolarCloud mundëson monitorim dhe shkëmbim dykahësh të të dhënave me pajisjet energjetike përmes komunikimit të kablluar dhe cloud. Ky funksionalitet përmbush kërkesën në aspektin e monitorimit dhe komandimit, në mënyrë të përshtatshme për sistemet fotovoltaike.

Në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 36 Specifikimet teknike, autoriteti kontraktor duhet të formulojë kërkesat teknike në funksion të objektit të kontratës dhe të pranojë zgjidhje teknologjike ekuivalente, pa favorizuar një teknologji të caktuar. Zgjidhja e propozuar, e bazuar në arkitekturë cloud (iSolarCloud) me komunikim RS485/Ethernet, monitorim dhe komandim dykahësh, përmbush funksionalisht kërkesat e specifikimit teknik. Për rrjedhojë, kërkesat për arkitekturë tradicionale DDC/BMS nuk mund të konsiderohen kusht thelbësor për objektin e kontratës dhe refuzimi mbi këtë bazë bie ndesh me parimet e parashikuara në Nenin 36 të ligjit.

Kriteri për dërgimin e mesazheve përmes GSM-SMS është një kërkesë funksionale dhe jo domosdoshmërisht e lidhur me praninë e një moduli fizik GSM të integruar në pajisje. Ky funksion mund të përmbushet lehtësisht dhe plotësisht përmes ndërveprimit me një nga operatorët telefonikë, duke përdorur shërbime të jashtme SMS (SMS Gateway), të cilat janë zgjidhje standarde dhe të konsoliduara në praktikën aktuale.

Në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 i Për prokurimin publik, i ndryshuar, Neni 36 Specifikimet teknike, kërkesat teknike duhet të fokusohen në rezultatin dhe funksionin e kërkuar,

dhe jo të imponojnë një zgjidhje të caktuar teknologjike, kur ekzistojnë alternativa teknologjikut ekuivalente. Për rrjedhojë, përmbushja e funksionit GSM-SMS përmes shërbimeve të operatorëve telefonikë përbën një zgjidhje të ligjshme, funksionale dhe të pranueshme.

“Duhet të mbështesë minimumi 3 rrethe kontrolli për ngrohje ose 2 rrethe kontrolli për ventilim, me mundësi zgjerimi përmes objekteve harduerike dhe (objekte harduerike)”. Sic shikohet me lart tek kërkesat dhe arsyet e skualifikimit kërkohej që sistemi i monitorimit të mbështesë sisteme ngrohje dhe ventilimi, KJO GJE NUK KA LIDHJE ME OBJEKTIN E PROKURIMIT NE FJALE APO ME FUNKSIONALITETIN E TIJ. PRA SIC DUKET QARTE SISTEMI I MONITORIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PERDORURA KANË TË BËJNË ME SISTEME PËR TRAJTIMIN E AJRIT DHE KONDICIONIMIN DHE JO ME OBJEKTIN E PROKURIMIT, I CILI ËSHTË NDËRTIMI I NJË IMPIANTI FOTOVOLTAIK. Mendojme që është lapsus dhe nuk mund të jete arsye skualifikimi për ne.

5- Kriteret Teknike Të dhënat teknike të pajisjes -Lidhjet e bus-it / ndërfaqet e komunikimit Kërkesa që komunikimi me BMS të realizohet vetëm përmes CAN, pa pranuar zgjidhje ekuivalente, përbën kufizim teknik që mund të ngushtojë në mënyrë artificiale konkurrencën dhe nuk është domosdoshmërisht proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu, inverteri Sungrow mbështet komunikim të kablluar (RS485/Ethernet) që është i mjaftueshëm për integrim total.

Në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 i Për prokurimin publik, i ndryshuar, Neni 36 Specifikimet teknike, autoriteti kontraktor është i detyruar të formulojë kërkesat teknike në funksion të objektit të kontratës dhe të pranojë zgjidhje teknologjikut ekuivalente, pa imponuar arkitekturë të caktuar hardware apo BMS/DDC. Kërkesat për bus fushe, CAN, RS232, BACnet routing dhe module fushore i përkasin sistemeve të automatizimit të ndërtesave dhe nuk janë proporcionale apo të aplikueshme për sistemet fotovoltaike, të cilat operojnë me arkitekturë cloud dhe komunikim standard industrial. Për rrjedhojë, vlerësimi jonë mbi këtë bazë nuk është i drejtë pasi me poshte po japim zgjidhjen ekuivalente teknologjike.

Edhe pse inverterët Sungrow nuk implementojnë drejtpërdrejt BACnet, CAN apo F-bus, ata ofrojnë komunikim të hapur dhe të dokumentuar përmes Modbus RTU / Modbus TCP/IP, si dhe integrim cloud përmes iSolarCloud. Këto mekanizma mundësojnë integrim funksional me sisteme BMS, përfshirë ato që përdorin BACnet, përmes zgjidhjeve gateway ekuivalente, duke përmbushur qëllimin e monitorimit, komandimit dhe shkëmbimit dykahësh të të dhënave. Përsa i përket nderlidhjes me rrethet e komunikimit, sistemi i monitorimit Sungrow mundëson komunikimin dhe integrimin funksional me të gjitha pajisjet e punës që mbështesin komunikimin TCP/IP. Përmes kësaj arkitekture moderne IP-based, sistemi siguron monitorim në kohë reale, shkëmbim të të dhënave, alarmim dhe mbikëqyrje operative të funksionimit.

Ky komunikim TCP/IP lejon ndërveprim të qëndrueshëm dhe të besueshëm me pajisjet përkatëse, duke garantuar integrim të plotë me sistemet ekzistuese të automatizimit dhe menaxhimit të impiantit, pa qenë i kufizuar në protokolle seriale tradicionale.

6- Memoria dhe Sistemi Operativ

Zgjidhja e propozuar bazohet në arkitekturë cloud, ku përpunimi, ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave realizohen në mënyrë të centralizuar dhe të sigurt përmes platformës iSolarCloud. Në

këtë kontekst, kërkesat për memorie Flash, RAM, mini-USV të brendshme, kategori mbivoltazhi, tension impulsesh, nivel ndotjeje apo metodë funksionimi, i përkasin pajisjeve hardware lokale të tipit BMS/DDC dhe nuk janë të aplikueshme për zgjidhje cloud-based.

Në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 i Për prokurimin publik, i ndryshuar, Neni 36 Specifikimet teknike, autoriteti kontraktor është i detyruar që specifikimet teknike të formulohet në funksion të rezultatit dhe funksionalitetit të kërkuar, dhe jo të imponojë arkitekturë të caktuar teknologjike ose konfigurim hardware specifik, kur i njëjti funksion realizohet përmes një zgjidhjeje tjetër teknologjike ekuivalente.

Zgjidhja cloud e propozuar garanton: ? ruajtje të sigurt dhe të vazhdueshme të të dhënave, edhe në rast ndërprerjeje energjie në pajisjet lokale; ? disponueshmëri dhe stabilitet funksional, pa varësi nga memorie apo sisteme operative lokale; ? monitorim dhe menaxhim të vazhdueshëm të sistemit fotovoltai, në përputhje me objektin e kontratës.

Për rrjedhojë, mungesa e parametrave hardware lokalë të listuar (Flash, RAM, mini-USV, etj.) nuk përbën mangësi teknike, pasi funksioni i kërkuar realizohet plotësisht përmes arkitekturës cloud, në përputhje me parimet e neutralitetit teknologjik, proporcionalitetit dhe pranimi të zgjidhjeve të ekuivalente, të sanksionuara në Nenin 36 të LPP.

Sistemi i monitorimit përfshin pajisje dhe metoda akuzicioni si Insight Monitoring System, Logger, Eye, WiFi, COM100 dhe pajisje të tjera grumbullimi të dhënash, me interval monitorimi çdo 5 minuta, duke garantuar analizë të vazhdueshme dhe të detajuar të të dhënave operative. Metodatat e komunikimit të përdorura përfshijnë 2G, 3G, 4G, WLAN dhe lidhje të dedikuara wired broadband, çka siguron fleksibilitet të lartë dhe besueshmëri në transmetimin e të dhënave. Në lidhje me protokollet e komunikimit, duhet sqaruar se sistemi mbështetet në komunikim IP përmes WLAN dhe rrjeteve wired, të cilat janë në të njëjtën linjë funksionale me protokolle standarde industriale si BACnet, CAN dhe protokolle të tjera të integritit, duke mundësuar shkëmbim të të dhënave, integrim me sisteme të tjera dhe ruajtje të eventeve dhe alarmimeve operative. Sistemi siguron gjithashtu ruajtjen e eventeve, trendeve dhe historikut të të dhënave, duke përmbushur kërkesat për analizë dhe gjurmueshmëri.

Sa i përket kapacitetit të ruajtjes së të dhënave, storage specification > 100 PB tejkalon ndjeshëm kërkesat minimale të parashikuara në dokumentet e procedurës së prokurimit, duke ofruar ruajtje afatgjatë, redundancë dhe siguri të lartë të të dhënave, në krahasim me sistemet tradicionale me memorie lokale të kufizuara.

Në lidhje me aksesin e përdoruesit, sistemi mundëson lidhje përmes shfletuesve standardë (browser) pa pasur nevojë për instalim të software-it shtesë, çka garanton përdorim të thjeshtë, fleksibilitet operativ dhe përputhshmëri të plotë me kërkesat për akses web-based nga PC, tablet ose pajisje mobile.

Shpejtësia e Komunikimit të të Dhënave

Në lidhje me shpejtësinë e komunikimit të të dhënave, sqarojmë se sistemi i monitorimit Sungrow, përmes pajisjes WiNet-S, tejkalon kërkesat minimale të parashikuara në procedurën e prokurimit. Pajisja WiNet-S mbështet komunikim Ethernet me vetë-adaptim 10/100 Mbps, si dhe komunikim WLAN IEEE 802.11 b/g/n në frekuencën 2.4 GHz, duke garantuar transmetim të shpejtë, të qëndrueshëm dhe të besueshëm të të dhënave operative. Këto parametra janë dukshëm më të larta se shpejtësitë minimale të kërkuara për komunikim në procedurë (40 kBd, 115kBd), të cilat zakonisht aplikohen për protokolle seriale industriale.

Ne perfundim kuptohet se në këtë pjesë të procedurës është bërë një lapsus njerëzor, ku janë përfshirë specifikime që i referohen një sistemi tjetër, dhe jo sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të një impianti fotovoltaik per disa parametra teknike te cilet jane permendur nga KVO si arsye skualifikimi per oferten tone te cilat lidhen qartësisht me SPECIFIKIME TEKNIKE TIPIKE TË NJË SISTEMI KONTROLLI DDC SI« JANË RRETHET E KONTROLLIT PËR NGROHJE DHE VENTILIM, BUS-E FUSHORE, MODULE KABINETI, PROTOKOLLE BACNET/CAN/F-BUS, ARKITEKTURË DDC, memorie dhe sistem operativ lokal, si dhe asnjë nga këto elemente nuk rezulton të jetë i përshkruar apo i kërkuar në dokumentacionin bazë të procedurës, konkretisht në Termat e Referencës, në formatin e ofertës teknike, në listën e materialeve dhe as në studimin/projektin paraprak , oferta jone duhet te konsiderohet ne teresi e vlefshme , pasi i permbush te gjitha parametrat thelbesore objekt prokurimi. Duke qene se pjese e procedures eshte dhe PROJEKTI I ZBATIMIT nga ana jone do te merret ne konsiderate përfshirja e te gjithë elementeve te nevojshem per realizimin e sukseshem te kontrates .

Sic u paraqiten argumentet teknike dhe ligjore që provojnë se sistemi teknik i ofertuar nga operatori ekonomik është në përputhje të plotë me parimet themelore të Ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publik, i ndryshuar, veçanërisht me Nenin 36 Specifikimet teknike, i cili parashikon se autoriteti kontraktor duhet të pranojë zgjidhje teknologjike ekuivalente të përmbushin të njëjtin funksion dhe objektivin e kontratës, pa vendosur kufizime të pajustificuara teknologjike.

Zgjidhja e propozuar garanton, gjithashtu, që impianti fotovoltaik të jetë i integrueshëm në të ardhmen në një sistem kontrolli , përmes ndërfaqeve dhe protokolleve standarde të komunikimit, në përputhje me parimet e neutralitetit teknologjik, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme të sanksionuara nga legjislacioni në fuqi.

Duke qenë se jemi operatori ekonomik me vlerën më të ulët të ofertuar dhe bazuar në ofertën tonë teknike, e cila është e ndërtuar mbi përdorimin e brandeve të njohura ndërkombëtare dhe produkteve të cilësisë së lartë, si dhe duke qenë se specifikimet teknike për të cilat jemi skualifikuar nuk përbëjnë specifikime të një sistemi që është objekt i kësaj kontrate, nuk e shikojmë të arsyeshëm dhe të justifikuar skualifikimin tonë nga kjo procedurë prokurimi.

Për shkak të specifikës së procedurës së prokurimit dhe nivelit të ekspertizës së saj, përpara vijimit me hapa të tjerë procedurale, KPP ka vendosur të thërrasë në këtë seancë dëgjimore autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik ankimues në lidhje me sqarimin e fakteve dhe rrethanave të ankesës së operatorit ekonomik ankimues dhe dëgjimit të autoriteti kontraktor. Konkretisht nga ana e Komisionit, pasi u shqyrtua ankesa e ankimuesit është konstatuar, se pretendimet që ngre operatori ekonomik janë në dokumentin me emërtimin “2.3.16-HTM – Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1 pdf”, të ngarkuar nga ky i fundit në sistemin e prokurimeve elektronike. Në lidhje me këto pretendime, KPP i ftoi palët në procesin administrativ me nr. 335 prot, duke zhvilluar një seancë dëgjimore me datë 23.02.2026. Komisioni iu drejtua palëve në këtë seancë nëse ka kërkesa paraprake prej tyre, dhe nuk pati asnjë kërkesë paraprake nga ana e tyre.

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua operatorit ekonomik “HTM” SHPK, si dhe autoritetit kontraktor, konkretisht ekspertëve të fushës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi mënyrën e përmbushjes së këtij kriteri.

Në fillim të seancës, Komisioni iu drejtua autoritetit kontraktor.

Pyetje drejtuar Autoritetit Kontraktor: *“Ku jeni fokusuar për hartimin e specifikimeve teknike sipas nenit 36 të LPP? Në cilin stardad kombëtar apo ndërkombëtar jeni mbështetur apo jeni fokusuar të kërkesat funksionale të objektit të prokurimit?”*

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): *“Në dijenin time për këtë procedurë është bërë një projekt, dhe është ngritur komisioni i specifikimeve teknike, i cili ka hartuar të gjitha specifikimet teknike, sipas projektit, sepse është një procedurë që vjen me fonde nga bashkimi europian, dhe për pjesën e specifikimeve teknike, në dijenin time, specifikimet e hartuara nga grupi punës kanë qënë edhe si të gatshme duke iu referuar projektit që është me fonde nga bashkimi europian, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare.*

Pyetje drejtuar Autoritetit Kontraktor: *“Në dijenin tuaj, këto lloj specifikimesh teknike të vendosura për këtë lloj procedure, plotësohen apo jo nga disa operatorë ekonomikë pjesëmarrës?”*

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): *“Për derisa ka patur pjesëmarrës, i bie që plotësohen”.*

1.- Pyetje drejtuar operatorit ekonomik “HTM” SHPK: “Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj si subjekt ankimues, konkretisht:

- **Për paisjen 1.7. “Panelet Elektrike, Kabujt AC dhe DC”**

1.7.6 Monitorimin i Energjisë

b) Kontrollim (jep komande)

- Inverterat (ndezje/fikje).

c) Gjenerimi i Raporteve

- Ditore, mujore dhe vjetore (by default).
- Raportet të gjenerohen në format “.xlsx” dhe “.pdf” dhe të ruhen në njehapesirë memorie lehtësisht të aksesueshme nga përdoruesi.
- Standardet IEC 104S / IEC 61850 ose ekuivalente

Mund të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1 pdf), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Përgjigjja e OE: *“Në dokumentin katalog “2.3.16-HTM – Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1 pdf”, që kemi ngarkuar në SPE, një ndër elementët janë komunikimi dhe monitorimi, që i përkasin prodhuesit SUNGROW, me të cilin ne kemi hyrë edhe me autorizim prodhuesi në procedurë. Në faqen 21 të këtij katalogu, kemi specifikimet teknike të kërkuara nga AK, paragrafi Intelligent and flexible, integrated management of*

multiple energy sources, kemi specifikimin “jep komand”. Në paragrafin Device type, që mund të lidhen dhe ndërlidhen dhe mund të komandohen nga ky softwair, shikojmë që kemi inverter, në faqen 21 të këtij katalogu. Ndërsa për gjenerimin e raporteve ditore, mujore dhe vjetore, këtë mund ta marrin nga intervali që ky softwair, bën matjen e parametrave, sic është fuqia, rryma, tensioni, interval shpejtësie cdo 5 minuta, në mënyrë të vazhdueshme dhe të pa ndërprerë.

Këto janë softuere by default nga prodhuesi, ku nuk mund të gjendet detaje kaq specifike në katalog. Raportet gjenerohen në format “.xlsx” dhe “.pdf” dhe të ruhen në një hapësirë memorie lehtësisht të aksesueshme nga përdoruesi. Prodhuesit sic është SUNGROW apo Canadian Solar, këto tipe të dhënash i ofron në programet për të cilat ofron edhe trajnime, nuk i japin në mënyrë të menjëhershme në internet. Edhe nuk kemi të drejtë të bëjmë deklarime të tilla. Për vërtetësinë e këtij kriteri gjatë ankesës që ne kemi bërë, kemi dhënë shembullit të të gjithë parametrave të matura dhe shkarkuara në memorjen dhe në dosjen apo folderin që ju parazgjidhni tek softueri, gjithashtu edhe tek komanda shutdown/start up. Kjo evidentohet në katalog, në faqen nr.21, pasi kjo është faqja e sistemit të monitorimit.(Real –time of cloud-based big data to avoid missing any valuable data).

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): “e vetmja gjë që mund të shtoj është se, nëq specifikimet teknike kanë qenë sic u shpreh edhe operatori ekonomik ankimues, ka patur afatin për të bërë ankesë, për të gjithë specifikimet që kanë qenë në dokumenta. Por aktualisht nuk kemi ankesë nga ky operator ose nga operatorë të tjerë.

Përgjigjja e OE: “Për të sqaruar edhe një herë, që kjo është kontratë me celsa në dorë, pra do bëhet projekti, edhe zbatimi edhe dorëzimi i mallit. Mënyrë e ofertimit nuk ka qenë në rastin sikur kemi një list materiale, por oferta ka patur 3 kapituj, (projekti, zbatimi dhe monitorimi) për të cilat është dhënë nga një vlerë financiare. Pra, nga momenti që unë bëj projektin, ia dërgoj autoritetit kontraktor, e shikojnë. Do ngrihet një grup pune i cili do të marrë në dorëzim projektin e bërë nga ofertuesi, dhe pasi bëhet përpunueshmëria me kërkesat e vet autoriteti, ky i fundit do citojë nëse është konform specifikimeve dhe kërkesave, nëse jo, unë si ofertues do ta rishikoj dhe ridërgoj përsëri projektin. Nga momenti që mua më miratohet projekti, bashkë me preventivin ku përcaktohet edhe e gjithë lista e materialeve.

Pyetje drejtuar Autoritetit Kontraktor: “Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj, mbi vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për përmbushjen e specifikimit teknik të kërkuar në dokumentat e tenderit, **për artikullin objekt prokurimi**. A janë kërkuara sqarime nga ana e KVO, në bazë të nenit 82 vijues, të VKM nr. 285 sqarime nga operatorët ekonomike pjesëmarrës apo operatori ekonomik ankimues, mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, në lidhje me këtë çështje?

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): “Atëhere, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka bërë vlerësimin mbi bazën e dokumentave të ngarkuar në SPE. Nuk kemi kërkuar sqarime, jemi bazuar vetëm të pjesa e dokumentacionit, kataloget që janë ngarkuar në sistem. Në momentin që ti e ke të shprehur në katalog që, ti e plotëson këtë specifikim, KVO ka bërë

vlerësimin e këtij specifikimi. Në momentin që ne nuk e shohim në katalog që nuk e plotëson këtë specifikim teknik, e vlerësojmë të paplotësuar”.

Pyetje drejtuar OE: *“Ndërkohë është edhe një specifikim tjetër, për këtë zë, panele elektrike, kabuj AC dhe DC, Standardet IEC 104S / IEC 61850 ose ekuivalente., ku sipas KVO nuk plotësohet ky lloj standardi. Mund të na evidentoni në katalog këtë lloj standardi të kërkuar nga ana e AK?*

Përgjigja e OE: *“Që të jemi të qartë këto lloj standardesh i përkasin fushës së komunikacionit, dhe bëjnë të mundur që pajisjet e komunikimit të transmetojnë të dhëna nga njëra pajisje tek tjetra. Duke qenë se është “ose ekuivalente”, ne kemi komunikimin me RS, të cilët janë përshtatur dhe bandërat e frekuencës që kjo pajisje monitorimi suporton, për të kryer një komunikim të suksesshëm, këto janë standarde komunikacioni. Ne kemi opsionin që të bëjmë edhe lidhje direkte fizike në portat RS 485, të cilët sic dihet në botën e telekomunikacionit, RS485 bën të mundur që të bëhet komunikimi me protokollet mbarë botërore sic është TCP/IP. Këto metoda dhe këto zgjidhje që ka pajisja, brendi Sungrow, për komunikimin, përmbushin funksionin që do të kryente ky standard. Kjo evidentohet në faqen nr. 18 të katalogut. (“Communication”). Si dhe në faqen nr.9 për inverterat, pajtueshmëria me rrjetin”.*

KPP gjykon, se nëse autoriteti kontraktor do të kishte paqartësi në vlerësimin për përmbushjen e këtij parametri teknik/specifikimi teknik, në kuptim të pikës 1, të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve. Si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në lidhje me pëktë pikë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Në lidhje me pikën 3, Komisioni i Prokurimit Publik për “Kriteret Teknike për Sistemet e Monitorimit dhe Menaxhimit”, specifikimet teknike nuk përmbushen nga OE ankimues, konkretisht:

“3-Kriteret Teknike për Sistemin e Monitorimit dhe Menaxhimit”

- Duhet të jetë stacion stand-alone për kontroll me rreth të mbyllur dhe të hapur, optimizim dhe monitorim funksionesh.
- Duhet të mbështesë minimumi 3 rrethe kontrolli për ngrohje ose 2 rrethe kontrolli për ventilim, me mundësi zgjerimi përmes objekteve harduerike dhe softuerike.
- Duhet të ketë funksione PLC, të lira dhe si makro fikse (objekte harduerike).
- Duhet të ketë objekte softuerike për rritje të efikasitetit energjetik dhe optimizim energjie.

Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, evidentohet një pranim pjesor nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, por nuk evidentohet qartë se për cilin parametër.

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): *“Ne kemi parë pjesën e specifikimeve teknike, që janë hartuar nga grupi i hartimit të specifikimeve teknike, është kërkuar një softwer që të dicka fizike, që të kesh edhe në monitorim edhe kur nuk ke internet. Dhe operatroi ka ofertuar një sistem që është i bazuar i gjithi në icloud. Në momentin që ne nuk kemi internet, si në administrat, nuk marrim dot asnjë lloj informacioni. Dhe në specifikimet teknike që ka shënuar grupi i hartimit të specifikimeve, që të kemi dicka fizike pra PLC, ftohje/ngrohje/ventilim, porta LAN dhe të tjerë. Dhe të gjitha këto specifikime që janë ofruar nga operatori janë në sistemin icloud, sipas KVO nuk i plotëson”.*

Pyetje drejtuar operatorit ekonomik “HTM” SHPK : *“mund të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1 pdf), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?”*

Përgjigjja e OE: *“Po të shikojmë në faqen nr. 21 të katalogut, sistemi i monitorimit, tek “Device type”, ne kemi gjithë llojet e pajisjeve që mund të suportoje ky sistem për tu ndërlidhur dhe për tu komunikuar. Në fq nr.21 që i përket sistemit të monitorimit. Pra kemi, sistemin meteo station, , electricity meter, Transformer, circuit breakers and other devices in the plant. Pra ky sistem monitorimi mund të ndërlidhet dhe mund të marrë informacione për monitorimin e të gjithë komponentëve dhe pajisjeve që suportohen të paktën një lloj komunikimi sic është TCP/IP, porta RS485, dhe sistemet modbus. Në lidhje me atë që thotë inxhinieri, me mungesën e rrjetit dhe të monitorimit të inverterit, mund të shkosh edhe fizikisht, se presupozohet që inverteri është një pajisje të cilën ti e ke të instaluar pranë ambjenteve tuaja, dhe ti shkon fizikisht, e monitoron, dhe të gjitha ato të dhëna që ti don mund ti marrësh fizikisht aty, edhe në nqs nuk ke rrjet”.*

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): *“Ideja është që, kemi një panel që është i përbërë nga PLC, që duhet të jetë dicka fizike. Kjo është edhe një nga pikat që sistemi icloud nuk e plotëson.”*

Përgjigjja e OE: *“Për tui rikthyer edhe një herë, kur nuk ka një listë materialesh, në momentin që ne dorëzojmë projektin, me grupin e punës u diskutonte që duhet bërë edhe ky element shtese, dhe ne do e përfshinin. Ne kemi zërin monitorim me një vlerë të caktuar, dhe do e*

kryerjmë sic e kërkon autoriteti kontraktor. Ne nuk kemi përpara një listë paterialesh, dhe unë kam cuar një produkt, pasi unë nuk kam element. Për të ndërtuar këtë projekt un do ti bëj vetë. Pra në momentin që unë do bëj projektin, do bëj edhe preventivin duke përfshirë të gjithë zërat specifikim për të ndërtuar produktin final. Unë nuk kam një listë materialesh dhe AK nuk ka e si të më kontrollojë mua që nuk kam përputhshmëri materialesh. Unë do bëj projektin vetë. Grupi i punës së Ak do të jetë ai që do të ma marri në dorëzim. Unë nuk bëj dot implementim të projektit në qoftëse AK nuk miraton projektin që do të hartohet nga ana jonë. Pasi projektimi ka vlerë, e cila paguhet nga vet AK, një vlerë me të cilën unë kam ofertuar në këtë procedurë.

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): “Në momentin që hidhen këto dokumenta të procedurës në sistemin e APP_së, është edhe afati i ankesave për operatorët. Këtë lloj gjëje që operatori ekonomik e ka patur të pa qartë, ka patur kohën e vet atëhere, që ti drejtonte një kërkesë për sqarim autoritetit kontraktor, për të sqaruar listën e materialeve, sic e shprehu tani. Detyra e KVO është që të kontrollojë dhe të verifikojë dokumentacionin q ëka hedhur operatori ekonomik . Pjesën pastaj përfundimtare që operatori ekonomik e bën si punë apo nuk arrin ta bëjë deri në fund, është Komisioni i marrjes në dorëzim. KVO ka për detyrë të kontrollojë dokumentacionin që ka hedhur operatori, plotëson ose nuk e plotëson këtë kriter apo specifikim, po ose jo”.

Përgjigjja e OE: “Për sqarim për AK, PLC është thjesht programe logical controller, merr dhe jep informacione. Përderisa sistemi i monitorimit që ne kemi ofertuar, ka dhe logger, dhe contrait dhe other ecuisition devices, ne e quajmë të përmbushur në funksionalitet këtë kërkesë. Në faqen nr. 21 të katalogut. Në lidhje me specifikimin që të ketë objekte softwerike për rritje të efikasitetit energjitik dhe optimizimin e energjisë, inverterat Sungrouth, madje kjo është dicka bazike për invertert e teknologjisë fotovoltaike, janë të pajisr me maksimum me MPPT, dhe kjo është në faqrn nr.9 të katalogut. (Maximum power point tracking).

Nga cfarë u diskutua në këtë seancë dëgjimore në lidhje me këto parametra teknik, dhe pas argumentave të dhënë nga palët në këtë proces ankimi, Komisioni gjykon se, referuar edhe parametrave teknik të hartuara nga vetë autoriteti kontraktor, rezulton që Sistemi i menaxhimit duhet të instalohet në pajisje fizike (server/kontroller industrial) me sistem operativ Linux të integruar dhe funksionim stand-alone.

Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Në lidhje me pikën 3, Komisioni i Prokurimit Publik për “Kriteret Teknike për Sistemet e Monitorimit dhe Menaxhimit”, specifikimet teknike nuk përmbushen nga OE ankimues, konkretisht:

“Komunikimi”

- Duhet të ketë funksion të integruar të kontrollit në distancë përmes PC-së me shfletues pa nevojë për softëare shtesë ose përmes pajisjeve mobile.
- Duhet të mbështesë BACnet natyror sipas standardit DIN EN ISO 16484-5, nëpërmjet BACnet IP dhe BACnet MS/TP.

- Duhet të mbështesë komunikim dhe shkëmbim të dhënash dykahëshe me deri në 99 stacione automatizimi.

Mund të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1 pdf), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Përgjigjja e OE: “Për arsyen e parë të skualifikimit që ju cituat, duke qënë se sistemi i monitorimit, është isolarcloud, kjo do të thotë që, përderisa është në icloud, ti mund të aksesosh këtë duke hapur një brauser të caktuar që ti ke të instaluar në PC, sic mund të jetë chrom, ose ndonjë nga broser e tjerë të prodhuesëve të ndryshëm. Dhe kjo gjendet në faqen nr. 21 të katalogut (isolarCloud). Për pikën e dytë, duke u nisur edhe nga LPP, që autoriteti kontraktor duhet të pranojë edhe zgjidhje ekuivalente, zgjidhje që në thelb të tyre duhet të kenë zgjidhjen funksionale të detyrës. Në shikojmë që tek metodat e komunikimit, sërish kemi dhe wired broadband, pra është komunikim me kabëll. BACnet është thjesht një protokoll, thjesht kabëll. Kjo gjendet në fq nr. 21 të katalogur, dhe kjo është një zgjidhje ekuivalente teknike. Në lidhje me pikën e tretë, ne e shikojmë tek aksesin maksimal ose të kapaciteti maksimal i aksesimit (maximum access capacity,>100GW), që është më tepër sesa “100Gigawat”, përsëri në të njëjtën faqe të katalogut”.

Nga çfarë u diskutua në këtë seancë dëgjimore në lidhje me këto parametra teknik, dhe pas argumentave të dhënë nga palët në këtë proces ankimimi, Komisioni gjykon se, referuar edhe parametrave teknik të hartuara nga vetë autoriteti kontraktor, rezulton që bëhet fjalë për një **pajisje fizike qendrore**, që integron sistemin fotovoltaiik me sistemin e menaxhimit të ndërtesës. Për pikën e dytë, sipas ankimuesit ky parametër gjendet në fq nr. 21 të katalogur, dhe kjo është një zgjidhje ekuivalente teknike e ofertuar nga ana e ankimuesit, por e cila bën ndesh me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në lidhje me këtë parametër nuk qëndron.

Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i operatoit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht për nënpikat e tjera.

Në lidhje me pikën 4, Komisioni i Prokurimit Publik për “**Ndërfaqet dhe bus-et**”

- Duhet të ketë minimumi 2 bus-e (bazuar në CAN) të konfigurueshme si bus kabineti elektrik ose bus fushe, për lidhje me module fushore ose module kabineti elektrik.

Mund të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1 pdf), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Përgjigjja e OE: “Për ndërfaqet dhe buset, është thjesht një komunikim nga pajisja që po bëjmë monitorimin tek pajisja që ne duam të marrim të dhëna, nëpërmjet një kabulli. Bus fushe është thjesht një kabëll. Dhe duke qënë se, inverteri jonë plotëson kriteret për të qënë në përputhje me wiredbroband, pra është një komunikim me kabëll, dhe gjithashtu porta e komunikimit që ka kjo pajisje është RS485, që mund të suportojë protokolle të ndryshme të komunikimit, atëherë funksionaliteti i kësaj detyre quhet i përmbushur.

KPP gjykon, se nëse autoriteti kontraktor do të kishte paqartësi në vlerësimin për përmbushjen e këtij parametri teknik/specifikimi teknik, në kuptim të pikës 1, të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve. Si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në lidhje me pëktë pikë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Në lidhje me pikën 4, Komisioni i Prokurimit Publik për “**Funksionaliteti dhe siguria**”

- Duhet të mundësojë dërgim të mesazheve përmes GSM-SMS dhe e-mail.
- Duhet të ketë memorie trendesh për minimumi 10.000 pika trendesh.
- Konfigurimi duhet të bëhet përmes strukture moderne objektuale, që redukton ndjeshëm kohën e projektimit.
- Sistemi duhet të bazohet në sistem operativ Linux të integruar, për funksionim të qëndrueshëm dhe të provuar.
- Duhet të garantojë monitorim të vazhdueshëm të komunikimit në bus dhe të gjithë komponentëve të lidhur DDC, me mundësi shkëmbimi dykahësh të të dhënave.

Mund të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1 pdf), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Përgjigjja e OE: “Për të sqaruar, prodhuesit nxjerrin një katalog tip, që mund ti ofrojë këto parametra, por nuk janë të përfshira në katalog, se pastaj i bie që prodhuesi të nxjerrë një katalog me mijëra faqe, ku për çdo prodhukt të evidentojë çdo specifikim. Pra është një katalog tip. Prodhuesi mund të prodhojë edhe një produkt të caktuar edhe sipas kërkesave të klientit.

Përgjigjja e AK (ekspert fushe, anëtar i KVO): “Tek katalogët e ngarkuar, operatori ekonomik dhe prodhuesi mund të dijë që, e paska si funksion por unë si KVO në momentin që nuk e kam të shfaqur tek dokumentacioni, më lind e drejta të them që nuk e plotëson”.

Përgjigjja e OE: “Tek motodat e komunikimit sic janë 2G,3G, 4G, wlan, wired broadband, dhe për të mbështetur këtë pikë që le të themi, sistemi i monitorimit që ne kemi ofruar, e

mbështet këtë mënyrë lajmërimi me email, gjatë ankesës kemi dhënë një shembull nga sistemi ynë, i monitorimit tip, ku është kërkuar që të shënohet emaili i personit. Në lidhje me pikën e dytë, sërish ky specifikim përmbushet në kapacitetin aksesues që ka ky lloj prodhuesi, që është më tepër se sa 100Gwat, dhe intervalet janë cdo 5 minuta, dhe gjithashtu tek storage specifications kemi më shumë se $\geq 100PB$. Në lidhje me pikën tretë dhe të katërt, përderisa kjo është një sistem monitorimi në icloud, të thekosjmë se SunGouwth, mund të ofrojë edhe instalimin e një aplikacioni monitorimi dhe në pjesë fizike që ne mund t'ju sjellim, nëse duan dika fizike. Por duke qenë se kjo është një sistem monitorimi në icloud, mund të integrohet edhe në sistem windows dhe në sisteme linux dhe në cdo lloj sistemi operativ të cilën ka metodë aksesimi në shfletues. Kjo vetë është e nënkuptuar nga metodologjia e arkitektues së sistemit të kontrollit të SunGrouwth. Në lidhje me pikën e pestë, argumentimi është i njëjtë sepse, le të themi që këto janë disa specifikime tepër specifike, të cilët në katalogët e prodhuesëve, brandet botërorë janë të nënkuptuara dhe duhet të jetë një person i fushës.

KPP gjykon, se nëse autoriteti kontraktor do të kishte paqartësi në vlerësimin për përmbushjen e këtij parametri teknik/specifikimi teknik, në kuptim të pikës 1, të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisionit të Vlerësimit të Ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve. Si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në lidhje me pëktë pikë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Në lidhje me pikën 5, Komisioni i Prokurimit Publik për “**Kriteret Teknike – Të dhënat teknike të pajisjes, Lidhjet e bus-it / ndërfaqet e komunikimit**”:

2x Ethernet RJ45 me sëitch të brendshëm:

Mbështet deri në 99 stacione automatizimi.

Mundëson rrjet global përmes komponentëve aktivë të rrjetit.

Lidhje me BMS dhe klientë BACnet.

2x CAN bus, të konfigurueshme si:

Bus fushe (F-bus): deri në 8 module fushore (FBM/FBU) dhe shtesë deri në 8 RBW4xxx.

Gjatësi max kablo: 2000 m.

Shpejtësi: 20 kD.

Protokoll: CAN.

Bus kabineti elektrik (SBM-bus): deri në 4 module kabineti (SBM ose BMA/BMD).

Gjatësi max kablllo: 200 m.

Shpejtësi: 40 kBd.

Protokoll: CAN.

1x USB: vetëm për USB stick, përditësim firmëare, backup dhe rikthim konfigurimi.

2x RS232:

1 port dedikuar për modem.

2x RS485:

1 port për komunikim BACnet MS/TP.

Mbështetje deri në 32 pajisje.

Gjatësi max kablllo: 1000 m.

Shpejtësi deri në 115 kBd.

Mundësi routing sipas BACnet/IP.

Mund të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1 pdf), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Përgjigjja e OE: “Duke qënë se ne kemi ofertuar sistemin tonë që mbështet portat e komunikimit RS485, vendosja e një suichi të jashtëm që ti bëj nga dy porta në 200 porta, nuk është ndonjë problem teknik, për sa i përket këtij specifikimi teknik. Kjo mund të merret nga inernet comonation, në faqen nr.18 të katalogut. Në lidhje me pikën e dytë i qëndrojmë argumentit të mëparshëm. Në lidhje me pikën e tretë, i qëndrojmë argumentit të mëparshëm në lidhje me komunikimet me sms dhe email. Në lidhje me pikën e katërt, duke qënë se, BMS është billi menagement system, dhe duke qënë se një BMS është thjesht disa komponent që ndëlidhen sëbashkë dhe komunikojnë, tek prodhuesi Sungrouth, këtë kriter e merr të mirëqene nga protokollet e komunikimit që këto kanë. Dhe gjithashtu, tek ankesa që ne kemi bërë i kemi paraqitur edhe Ak, një ndërfaqe në sistemin tonë të monitorimit që thotë, që jep një alarm të BMS comunionin fault. Pra sistemi jonë është plotësisht i ndërlidhshëm me BMS. Në lidhje me pikën e pestë, për krietrin CAN bus ne kemi shkuar gjithmon zgjidhjes së ekuivalencës teknologjike, sipas nenit 36 të LPP, dhe është tek sistemi i monitorimit, në faqen nr. 21 të katalogut. Në lidhje me pikën e gjashtë, është sërish i njëjti argumentim për sa i përket protokollit të komunikimit, që ka pajisja dhe duke qënë se ka protokolle komunikimi ëired, këto janë lehtësisht të realizueshme për sa i përket funksionalitetit të sistemit. Në lidhje me pikën shtatë, kjo është një pikë që i takon edhe kur të bëhet projekti, duke qënë se mbështetet tek protokollit TCP/IP, nëpërmjet portës së komunikimit RS485, gjatësia e kabëllit mund të jetë më shumë se 2000m, ky është një argumentim teknik i cili në katalog merret gjithmon i nënkuptuar. Në lidhje me pikën tetë, të faqia nr 18 i katalogut, nga 250kb, ne kemi 10-100Mb. Në lidhje me pikën nëntë, protokollit CNA, është një protokoll komunikimi, sërish ne kemi dhënë një zgjidhje teknologjikisht ekuivalente nëpërmjet protokolleve tona të komunikimit. Tek faqia nr. 21 e katalogut tek metodat e komunikimit. Në lidhje me pikën dhjetë, bus kabineti elektrik si dhe nga ana teknike është thjesht një kabull, i cili qarkullon brenda për brenda kuadrit elektrik. Dhe duke qënë se ne kemi wierd comunication ky kriter nga ana jonë quhet i përmbushur në thelbin e funksionalitetit.

Gjatë zhvillimit të seancës, operatori pati nevojë për më tepër kohë në dispozicion për gjetur cdo parametër (specifikim teknik), dhe për këtë arsye Komisioni iu la kohë në dispozicion palëve në këtë seance dëgjimore që deri me datë 25.02.2026 brenda orarit zyrtar, ankimuesi edhe autoriteti kontraktor mund të dërgojnë argumenta shtesë mbi përbushjen apo jo të parametrave teknik. Në lidhje me pikën njëmbëdhjetë, ankimuesi kërkon më tepër kohë.

Përgjigjja e OE: “Në lidhje me pikën dymbëdhjetë, sërish shpjeguesia që ka sistemi ynë i komunikimit është lehtësisht i verifikueshëm. I njëjti argumentim si më sipër. Në lidhje me pikën e trembëdhjetë, kemi zgjidhje teknologjike analoge ekuivalente. Në lidhje me pikën katërbëdhjetë, duke qenë se upgraidet që ka sistemi ynë i monitorimit kryhen në mënyrë automatike nga prodhuesi Sun Grouth, icloud solar, kjo mund të pranohet le të themi si zgjidhje ekuivalente për të kryer funksionalitetin për të qenë sistemi i azhurnuar në funksionalitet më të fundit që ofron një prodhues. Në lidhje me pikën pesëmbëdhjetë, sic e argumentuam më sipër. Në lidhje me pikën gjashtëmbëdhjetë, duke qenë se, portat e komunikimit që ka inverteri janë është RS485, ne mund të dërgojmë atë në një switch dhe mund ta shpërndajmë në sa më shumë pajsie të jetë e mundur. Në lidhje me pikën shtatëmbëdhjetë, i qëndrojmë sërish të njëjtit argumentim që bëme. Në lidhje me pikën tetëmbëdhjetë, sic e diskutuam edhe më sipër. Në lidhje me pikën nëntëmbëdhjetë, i qëndrojmë sërish të njëjtit argumentim. Në lidhje me pikën njëzetë, i qëndrojmë sërish të njëjtit argumentim. Në lidhje me pikën njëzet e një, shpjeguesia që sistemi ynë ofron jo në kb por në Mb, kshu që i qëndrojmë sërish të njëjtit argumentim. Në lidhje me pikën njëzet e dy, pajisjet tona kanë një zgjidhje ekuivalente, dhe mund të kryejë komunikim ndërmjet tyre, sic është TCP/IP.

Në lidhje me pikën 6, Komisioni i Prokurimit Publik për **“Memoria dhe Sistemi Operativ”**

Memorie totale: 4 GB Flash.

Memorie RAM: 512 MB.

Sistemi operativ: Embedded Linux.

Siguria dhe mbrojtja

Ruajtje e të dhënave në rast të ndërprerjes së energjisë përmes mini-USV të brendshme.

Kategoria e mbivoltazhit: III.

Tensioni i impulseve të vlerësuar: 800 V.

Niveli i ndotjes: 2.

Metoda e funksionimit: Tipi 1.

Mund të na tregoni se, në cilën faqe të katalogëve respektivë të ngarkuar prej jush në sistemin e prokurimit elektronik SPE (2.3.16-HTM –Kataloge_Lista_Mallrave_Prokurimit_1 pdf), keni markuar specifikimin teknik të kërkuar?

Përgjigjja e OE: “Duke qenë se ne kemi dhënë një zgjidhje në icloud, pra që mund të aplikohet në cdo njësi, në cdo pajisje fizike hardwari, ne nuk e shikojmë si një pikë problematike për tu përmbushur gjatë fazës së zbatimit sepse ne mund ti sjellim një njësi qëndrore që i përmbush të gjithë këto kërkesa për memorien që këta mund ta aksesojnë sistemin nga ajo. Në lidhje me pikën e dytë, memoria që ofron sistemi ynë në icloud, është më e madhe. Në lidhje me pikën e tretë, sic e argumentuam edhe më parë, sistemi ynë i monitorimit ka përputhshmëri edhe me

sistemin Linux dhe me sistemin windows, me të gjitha sistemet operative që janë në treg. Në lidhje me pikën e katërt, atëherë sistemi unë i monitorimit ka një ruajtje të të dhënave të pa ndërprerë, pa asnjë lloj varësie të energjisë elektrike, dhe nga vetë fakti që është në iclaud. Në lidhje me pikën e pestë, duke qenë se është në iclaud nuk është nevoja për një sistem të tillë. Në lidhje me pikën e gjashtë, sërish i njëjti argumentim, sistemi që kemi dhënë , është dhënë një zgjidhje teknike që përmbush funksionalitetin e saj. Në lidhje me pikën shtatë, duke qenë se është në iclaud, le të themi që nuk e kemi. Në lidhje me pikën e tetë, duke qenë se është në iclaud, e ritheksojmë edhe një herë, që sistemi përmbush funksionalitetin që duhet të kryejë si një sistem dhe nuk ka nevojë për pajisje të tilla shtesë, që të cilat janë të tepërta në këtë rast.

Në lidhje me pikën 5 dhe 6 të arsyeve të skualifikimit, të trajtuara edhe në këtë seancë dëgjimore, Komisioni konkludon se, nga shqyrtimi i specifikimeve teknike/parametrave teknik të hartuar nga autoriteti kontraktor, të pranuar edhe vetë nga ky I fundit, që kërkohet një pajisje monitorimi edhe fizike, ndërkohë operatori ekonomik ankmoues ka dhënë si ofertë teknike një sistem monitorimi online në sistemin iclaud, duke rënë ndesh me specifikimet teknike në DST.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të operatorit ekonomik, se ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesave mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110 pika 1 e LPP. Konkretisht në nenin 110, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Rezulton se ankimuesi është njohur me dokumentet e tenderit në datën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe afatet e ankimit për dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi për ankimuesin, nisin nga dita e publikimit të tyre dhe mbarojnë në ditën e shtatë sipas parashikimit ligjor në nenin 110, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Operatori ekonomik është palë e interesuar në përmbushje të të gjitha kërkesave të DST, me qëllim fitimin e kontratës, ndaj ofertimi i mallrave në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim është i rëndësishëm. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Komisioni gjykon, se bazuar në dokumentacionin e dosjes administrative, është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë operatorët ekonomikë i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Në lidhje me ofertën teknike të dhënë nga ankimuesi, i cili ka dhënë një zgjidhje teknike të propozuar si alternativ zgjidhjeje por që bie ndesh me kërkesat e autoriteti kontraktor. Në seksionin 2 “Objekti i Kontratës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.15 Pranohen variantet:

Po



Jo

X

Pra KPP thekson, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se nuk do të pranohen variantet.

Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik ka detyrimin të dorëzojë në cilësinë e pajisjes vetëm një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në kuptim dhe në zbatimin të parimit të barazisë në trajtimin e kandidatëve/ofertuesve, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit duhet të tregojë kujdes që të përcaktojë të njëjtat të drejta dhe detyrime në radhët e pjesmarrësve. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e një model/variant sipas specifikimeve/karakteristikave nuk krijon konfuzion tek ofertuesit në plotësimin e kërkesës. KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, ndërsa ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në lidhje me pikat 5 dhe 6, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, bazuar në faktet dhe informacionin e depozituar në Komisionin e Prokurimit, si dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 23.02.2026 në mjediset e KPP-së, me përfaqësues ekspert fushe të operatorit ekonomik, “HTM” SHPK, si dhe përfaqësues ekspert fushe, anëtar i njësisë së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nga ana e autoritetit kontraktor, i cili ka qenë pjesë e grupit të punës të ngritur për vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, rezulton, se në përfundim të këtij seksioni në lidhje me sa u deklarua më lart, përfaqësuesi i autoritetit kontraktor dhe përfaqësues të subjektit “HTM” SHPK, u sqaruan në mënyrë shteruese mbi paqartësitë dhe u saktësuan mbi përmbushjen e specifikimeve teknike për parametarat specifik të pajisjes së sipërcituar.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioni iu drejtua paleve në këtë proces ankimimi, për gjithcka u deklarua në këtë seancë dëgjimore, palët kanë dy ditë (25.02.2026) kohë për të dhënë argumenta brenda datës 25.02.2026, brenda orarit zyrtar të punës, nëpërmjet cdo lloj forme komunikimi, email apo shërbim postar. Në fund të seancës dëgjimore, Komisioni iu drejtua palëve të pranishme, nëse kishin pretendime apo kërkesa dhe nuk kishte.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “LAVIVA TECHNOLOGIES” SHPK, për sa kohë autoriteti kontraktor ka pranuar disa nga pretendimet e OE “HTM” shpk, dhe është skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do ti marrë në shqyrtim, pasi statusi i këtij subjekti do të vijojë të ngelet i skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike. Operatori ekonomik “LAVIVA TECHNOLOGIES” SHPK, nuk ka ardhur as me formular ankese dhe as me formular argumentash në kuptim të nenit 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar, për operatorin ekonomik “HTM” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68215-11-10-2025, me objekt " ZBATIMI I PLANIT PILOT: BLERJA DHE INSTALIMI I PANELEVE DIELORE”. (Kontratë me Celësa në dorë), me fond limit 17.777.820 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 22.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës dhe Autoriteti Kontraktor të pasqyrojë zbatimin e vendimit sipas vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “HTM” SHPK, duke zbatuar Vendimin e KSHA-së me nr. 612 prot., datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 335/3 prot., datë 18.02.2026, me objekt “Kthim përgjigje ankesës online nr.aplikimi A2026/6302, datë 03.02.2026”.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “HTM” SHPK, për procedurën e prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “HTM” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “HTM” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiovent Zguro

